Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria e Kosovës - Vlada Kosova - Government of Kosova
Zyra e Kryeministrit – Ured Premijera
Office of the Prime Minister

AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

RAPORTI VJETOR 2014



Prishtinë, Qershor 2015

RAPORTI VJETOR 2014

Prishtinë, Qershor 2015

Përmbajtja

Faqe

HYRJE 6

1. PERFORMANCA E ASK-së 7

1.1. Legjislacioni dhe dokumentet e tjera me rëndësi 7

1.2. Funksionimi i Këshillit Statistikor 7

1.3. Bashkëpunimi i ASK-së 8

1.4. Statistikat Ekonomike dhe Llogaritë Kombëtare 9

1.5. Statistikat Sociale 10

1.6. Statistikat e Bujqësisë dhe të Mjedisit 11

1.7. Përpunimet e Veçanta të Statistikave Zyrtare 11

1.8. Metodologjia, Shpërndarja dhe Teknologjia Informative 12

1.9. Riorganizimi dhe Ngritja e Kapaciteteve në ASK 13

1.10. Pasqyrat e Performancës së ASK-së 14

2. ANALIZA E PRIORITETEVE 244

3. BUXHETI 266

4. SFIDAT 31

SHTOJCA 1. *Të dhënat për të punësuarit në Shërbimin Civil të Kosovës në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, dhjetor 2014.* 29

SHTOJCA 2. Trajnime, seminare, punëtori, etj. 30

SHTOJCA 3. Kalendari i Publikimeve 2014 42

Lista e shkurtesave

ABEF	-	Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare
AFP	-	Anketa e Fuqisë Punëtore
BPV	-	Bruto Produkti Vendor
DMTI	-	Departamenti i Metodologjisë dhe i Teknologjisë Informative
DSELLK	-	Departamenti i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare
DSS	-	Departamenti i Statistikave Sociale
FMN	-	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IÇIMP	-	Indeksi i Çmimeve të Importit
IÇK	-	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IÇP	-	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit
IKN	-	Indeksi i Kostos së Ndërtimit
KB	-	Kombet e Bashkuara
KKIQ	-	Klasifikimi i Konsumit Individual sipas Qëllimit
KNS	-	Klasifikimi Ndërkombëtare i Sëmundjeve
MD	-	Ministria e Diasporës
MPJ	-	Ministria e Punëve të Jashtme
MTI	-	Ministria për Tregti dhe Industri
NK	-	Nomenklatura e Kombinuar
NACE (ang.)	-	Nomenklatura për Klasifikimin e Aktiviteteve Ekonomike
PFB	-	Pariteti i Fuqisë Blerëse
QR	-	Qarku Regjistrues
R1, R2, R3,	-	Formularët Individualë nga Regjistrimi i Popullsisë
STJ	-	Statistikat e Tregtisë së Jashtme
SH	-	Sistemi i Harmonizuar
SIPK (ang.)	-	Sistemi i Përdorimit të Kohës
KVP	-	Korniza e Vlerësimit të Performancës
DRA	-	Departamenti i Regjistrimit dhe Anketimit
MICS (ang.)	-	Anketa e Grupimit të Treguesve të Shumëfishtë
ISBN (ang.)	-	Numri Standard Ndërkombëtar i Librit

GIS (ang.)	-	Sistemi Informativ Gjeorgrafik
PSZ	-	Programi i Statistikave Zyrtare
MeM	-	Marrëveshje e Mirëkuptimit
MGSC (ang)	-	Grupi menaxhmentit per bashkëpunim statistikor
ESSPROS (ang)	-	Sistemi evropian i integruar për mbrojtjen e statistikave sociale
LAMAS (ang)	-	Grupi punues i Eurostatit për statistikat e tregut të punues
SDMX (ang)	-	Shkëmbimi i të dhënave statistikore dhe metadatat
ITDG (ang)	-	Grupi i drejtorëve për teknologji informative
CPSA (ang)	-	Komiteti drejtues për statistikat bujqësore
DIMESA (ang)	-	Takimet e drejtorëve për statistikat e mjedisit dhe llogarive
SBS (ang)	-	Statistikat strukturore të biznesit
ITGS (ang)	-	Statistikat në mallrat e tregtisë ndërkombëtare
ETS (ang)	-	Statistikat e trajnimit në arsim
ESS (ang)	-	Sisitemi evropian statistikor
DGINS (ang)	-	Drejtoret e përgjithëshëm të zyrave statistikore kombëtare
DMES (ang)	-	drejtoret e statistikave makroekonomike
EFGS (ang)	-	Forumi evropian për statistikat gjeografike
PGSC (ang)	-	Grupi i politikave për bashkëpunim statistikor
BoP (ang)	-	Bilanci i pagesave
CGST (ang)	-	Grupi për koordinimin e statistikave të transportit
ICT (ang)	-	Teknologjia për informim dhe komunikim

HYRJE

Raporti Vjetor 2014, nga ana e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) bëhet për herë të tretë, sipas obligimit ligjor nga Neni 7, Pika 2.8 e Ligjit për Statistika Zyrtare, Nr. 04/L-036. Ky raport ndryshon nga Raporti i Rregullt Vjetor, i dërguar nga ASK-ja, sipas procedurave të tjera administrative në ZKM.

Ligji për Statistikat Zyrtare, si dhe të gjitha aktet nënligjore që janë aprovuar nga Kryeministri dhe Qeveria e Republikës së Kosovës janë zbatuar me përpikëri nga ASK-ja.

Po ashtu, konform Ligjit për Statistikat Zyrtare dhe standardet ndërkombëtare, duke u bazuar në kërkesat e shfrytëzuesve, si dhe duke shfrytëzuar rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare dhe të Këshillit Statistikor, ASK-ja ka hartuar dokumente me rëndësi, si: Planin Vjetor 2015 dhe Hartën Rrugore 2015.

Edhe gjatë vitit 2014, ASK-ja i ka kushtuar rëndësi fuqizimit të bashkëpunimit me organizata vendore dhe ndërkombëtare, me qëllim të konsolidimit të sistemit statistikor bashkëkohor në Kosovë. Gjatë kësaj periudhe, i është kushtuar rëndësi edhe vendosjes së një bashkëpunimi dhe komunikimi, sa më të mirë, me shfrytëzuesit e statistikave zyrtare. Kjo ka ndikuar në përmirësimin e cilësisë së statistikave zyrtare.

Në vitin 2014 është bërë Regjistrimi i Bujqësisë, si dhe janë publikuar të dhëna të rëndësishme socio-ekonomike për vendin, me theks të veçantë publikimi i Bruto Produktit Vendor (BPV) në baza tremujore, mbështetur nga njësitë mbështetëse të ASK-së.

Bazuar në Nenin 33, të Ligjit për Statistikat Zyrtare, ASK-ja ka prodhuar statistikae zyrtare, sipas përpunimit të veçantë të tyre. Në këtë drejtim, janë aplikuar standardet ndërkombëtare, janë rritur kapacitetet e ASK-së dhe është rritur gama e prodhimeve statistikore.

Vazhdimësia e ngritjes së kapaciteteve në ASK ishte, po ashtu, prioritet gjatë kësaj periudhe raportimi. Pozitat e lira, janë plotësuar në vazhdimësi, kurse me ndihmën e donatorëve, stafi i ASK-së është trajnuar në fusha të rëndësishme statistikore. Gjithashtu, edhe buxheti i ASK-së është shfrytëzuar sipas planifikimeve.

ASK-ja, gjatë vitit 2014, ka pasur sfida në shumë fusha, që nga mungesa buxhetit dhe e kapaciteteve, e deri te përmirësimi i cilësisë dhe sasisë së prodhimeve të statistikave zyrtare.

Raporti Vjetor 2014, përveç plotësimit të obligimit ligjor, ka për qëllim, ta mbajë të informuar shfrytëzuesin, institucionet e vendit dhe ato ndërkombëtare, për të arriturat dhe sfidat e Sistemit Statistikor të Kosovës, gjatë vitit 2014.

1. PERFORMANCA E ASK-së

1.1. Legjislacioni dhe dokumentet e tjera me rëndësi

ASK-ja, gjatë vitit 2014, ka marrë pjesë në hartimin e disa draft-ligjeve me rëndësi për Republikën e Kosovës. Kontributi i drejtpërdrejtë i stafit të ASK-së ka qenë në procesin e draftimit të plotësim-ndryshimit të Ligjit për Statistikat Zyrtare, draftimit të projekt-ligjit për regjistrimin e popullsisë në katër komunat veriore të Kosovës, të cilat nuk kanë marrë pjesë në Regjistrimin e Popullsisë 2011, si dhe në procesin e amandamentimit të Ligjit për Regjistrimin e Bujqësisë.

Janë nënshkruar disa marrëveshje mirëkuptimi me institucione vendore dhe ndërkombëtare, si: MeM ndërmjet ASK-së dhe ATK-së, MeM ndërmjet MASHT-it dhe ASK-së, MeM ndërmjet ASK-së dhe RTK-së dhe MeM ndërmjet ASK-së dhe UNHCR-së.

Gjatë kësaj periudhe janë hartuar këto dokumente: Planin Vjetor 2015, Harta Rrugore 2015, Raporti Vjetor 2013.

Amandamentimi i Ligjit për Regjistrimin e Bujqësisë dhe dokumentet e tjera me rëndësi janë hartuar në bazë të standardeve ndërkombëtare për statistikat zyrtare. Gjë, që ka ndikuar në një performancë më të mirë të ASK-së. ASK-ja ka përgatitur koncept-dokumentin dhe draftin e Plotësim-Ndryshimit të Ligjit për Statistika Zyrtare, bazuar në rekomandimet e Eurostat-it, Këshillit Statistikor, etj., me qëllim të ngritjes së performancës dhe fuqizimit të pavarësisë institucionale dhe profesionale.

1.2. Funksionimi i Këshillit Statistikor

Këshilli Statistikor (KS) funksionon sipas Vendimit të Kryeministrit të Republikës së Kosovës, Nr. 097/2012 dhe Rregullores së KS në bazë të Ligjit për Statistikat Zyrtare, Nr. 04/L-036.

KS në të shumtën e rasteve ka marrë pjesë aktive në procesin e hartimit të dokumenteve me rëndësi, siç janë planet vjetore, marrëveshjet e mirëkuptimit dhe ka ofruar rekomandime të rëndësishme, që janë përfshirë në këto dokumente.

Funksionimi i KS-së është me rëndësi për ASK-në dhe Sistemin Statistikor të Kosovës, pasi që ky Këshill ka rol këshilldhënës për prodhimin e statistikave zyrtare.

Gjatë vitit 2014 funksionimi i KS-së ka pasur pengesa, për shkak të dorëheqjeve të kryetarëve të KS-së, si dhe mospjesëmarrjes së rregulltë të disa anëtarëve të këtij këshilli. ASK-ja këto probleme i ka adresuar, sipas Ligjit të Statistikave Zyrtare, te institucionet përkatëse, të cilat kanë përfaqësuesit e tyre në KS, me qëllim që pjesëmarrja e përfaqësuesve të tyre në KS të jetë e rregulltë.

Pozitat e dorëhequra janë plotësuar sipas Rregullores së Këshillit Statistikor dhe Ligjit për Statistikat Zyrtare, bazuar në Vendimin e Qeverisë së Kosovës për themelimin e KS-së.

1.3. Bashkëpunimi i ASK-së

Bashkëpunimi ndërinstitucional, gjatë vitit 2014, është konsideruar me prioritet. Gjithashtu, është fuqizuar bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare statistikore, gjë që ka mundësuar prodhimin e statistikave të krahasueshme me statistikat e prodhuara në sisteme të tjera statistikore. Bashkëpunimi me institucionet joqeveritare dhe donatorët është rritur. Prandaj, ky fuqizim i bashkëpunimit ka mundësuar rritjen e sasisë, të cilësisë dhe të frekuencës së statistikave zyrtare sipas standardeve ndërkombëtare.

Gjatë kësaj periudhe është realizuar një komunikim dhe informim më efikas me shfrytëzuesit e të dhënave statistikore. Janë aplikuar metoda të ndryshme për komunikim me përdorues, siç është ligjërata në Universitetin Publik të Prishtinës, komunikimi përmes mediave, debateve radio-televizive, kontakteve me përdorues, qofshin institucione publike, organizata a individë. Të gjitha raportet rreth komunikimit dhe informimit të përdoruesve, tregojnë se performanca është rritur në raport me pritjet e përdoruesve. Kjo është treguar edhe nga Anketa mbi Kënaqshmërinë e Përdoruesve.

Gjatë monitorimit të mediave, në vitin 2014 janë hasur 248 shkrime në gazeta dhe 1,136 në mediat online, që kishin të bënin me ASK-në. Po ashtu, gjatë vitit 2014, nga palë të interesuara dhe mediat, ASK, ka pranuar 240 pyetje, për të cilat janë dhënë 211 përgjigje. Kurse, prej 26 kërkesave për prononcime në media (paraqitje në TV) janë realizuar 21 prej tyre.

Figura: 1.1. Prania e ASK-së në media dhe përgjigjet ndaj përdoruesve të statistikave



Sa i përket numrit të vizitorëve që kanë vizituar ueb faqen e ASK-së, vërehet një rritje e vazhdueshme. Sipas raportit të gjeneruar nga Google Analytics (mjet zyrtar i Google, që monitoron numrin e vizitorëve), vetëm gjatë vitit 2014 janë regjistruar 82 580 vizitorë, të cilët kanë shfletuar gjithsej 915 675 faqe.

Figura: 1.2. Përdoruesit dhe vizitorët e ueb faqes së ASK-së

Në saje të ndihmës dhe bashkëpunimit me donatorë, vitin e kaluar është realizuar Projekti i Regjistrimit të Bujqësisë. Kurse, në kuadër të Projektit katërvjeçar të bashkëpunimit ndërmjet SIDA-s dhe ASK-së, është punuar në Komponentet: e Menaxhimit; të Statistikave Ekonomike, përfshirë Statistikat Agromonetare; të Statistikave të Mjedisit; të Statistikave Sociale; dhe zhvillimit të TI-së dhe Diseminimit. Ndërkaq, është vazhduar me realizimin e Projektit të Binjakëzimit, me Komponentet: Menaxhimi i Cilësisë, Llogaritë Kombëtare, Statistikat e Biznesit dhe ajo e TI-së. Kanë vazhduar mbështetjet nga fondet e IPA-s përmes pilot-projekteve; në bashkëpunim me UNICEF-in është vazhduar me realizimin e Projektit të AGTSH-së; në bashkëpunim me UNDP-në është mbështetur projekti i AFP-së, etj. Në saje të bashkëpunimit me SIDA/SCB, ASK-ja është përkrahur me shtatë praktikantë, si pozita të përkohshme, në kuadër të tri departamenteve prodhuese.

Si rezultat i bashkëpunimit ndërinstitucional, rritjes së komunikimit dhe informimit me përdoruesit e të dhënave, si dhe bashkëpunimit me donatorë, ASK-ja ka ngritur kapacitetet profesionale, cilësinë dhe sasinë e statistikave zyrtare, duke i përafruar ato me standardet e statistikave ndërkombëtare.

1.4. Statistikat Ekonomike dhe Llogaritë Kombëtare

Gjatë vitit 2014 janë bërë përparime në statistikat ekonomike dhe llogaritë kombëtare, duke arritur objektivat e planifikuara, si: shkurtimin e afateve të publikimeve dhe rritjen e numrit të produkteve. Nga 1 shtatori 2014 (sipas Rregullores Nr. 11/2013) është kaluar nga NACE[1] Rev.1 në NACE Rev.2. Të gjitha publikimet, nga kjo datë, janë publikuar me NACE Rev.2. Gjithashtu, janë bërë edhe ndryshimet e të dhënave në vitet paraprake, nga viti 2008. Llogaritë Kombëtare në baza vjetore janë publikuar sipas metodologjisë së re (ESA 2010). Në dhjetor të vitit 2014, për

[1] Nomenklatura e Veprimtarive Ekonomike

herë të parë është publikuar Bruto Produkti Vendor në baza tremujore (TM1 2010 deri TM1 2014) me të dy qasjet (atë të prodhimit dhe të shpenzimeve) me çmime aktuale dhe konstante. Në baza tremujore janë publikuar edhe Indeksi i Kostos së Ndërtimit dhe Statistikat e Industrisë.

Gjatë vitit 2014 nga Llogaritë Kombëtare janë publikuar: Llogaritë Qeveritare për vitin referues 2013; Bruto Produkti Vendor (BPV) 2013 me qasjen e shpenzimeve; dhe BPV 2013 me qasjen e prodhimit. Mbeshtetur nga IPA 2012, kemi filluar me Projektin për përshkrimin e metodologjisë, dhe burimeve për Llogaritë Kombëtare.

Në Sektorin e Çmimeve janë publikuar: "Indeksi i Çmimeve të Konsumit" (IÇK), në baza mujore, për periudhën dhjetor 2013 - nëntor 2014; "Indeksi i Çmimeve të Konsumit" IÇK 2013, në baza vjetore; "Indeksi i Çmimeve të Prodhimit" (IÇP), "Indeksi i Çmimeve të Importit" (IÇIMP) dhe "Indeksi i Kostos së Ndërtimit" (IKN) në baza tremujore për periudhat (TM4 2013-TM3 2014).
Po ashtu, gjatë vitit 2014 janë bërë përgatitjet finale për kalkulimin e "Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit" (IHÇK). Është vazhduar me Projektin e Paritetit të Fuqisë Blerëse (PFB), që është në kuadër të Programit të Krahasueshmërisë Evropiane (ang. ECP) i mbështetur nga fondet e IPA-së.

Nga Statistikat e Tregtisë së Jashtme (STJ) janë publikuar: STJ në baza mujore për periudhën dhjetor 2013-nëntor 2014 dhe STJ 2013 në baza vjetore. Në Statistikat e Biznesit janë publikuar, në baza tremujore për periudhën (TM4 2013 -TM3 2014): Repertori Statistikor mbi Ndërmarrjet Ekonomike, Statistikat e Transportit, Statistikat e Hotelerisë, Bilanci i Energjisë dhe Statisitkat e Industrisë. Kurse, në baza vjetore janë publikuar rezultatet e Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve për vitin 2013. Me qëllim të ngritjes së cilësisë së Regjistrit Statistikor të Bizneseve është realizuar Anketa për Përditësimin e Regjistrit Statistikor të Bizneseve. Ndërkohë, është filluar me krijimin e një platforme të re të Regjistrit Statistikor të Bizneseve (RSB).

1.5. Statistikat Sociale

Departamenti i Statistikave Sociale (DSS) në vitin 2014, nga 22 publikimet e planifikuara, ka realizuar 21 publikime, duke përfshirë publikimet vjetore dhe ato tremujore. Në fushën e Statistikave Sociale janë realizuara 15 publikime, ndërsa në fushën e Statistikave të Popullsisë janë publikuar 6 publikime.
Në kuadër të statistikave sociale, gjatë vitit 2014, janë realizuar këto publikime: Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore për vitin 2013; Rezultatet e Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare për vitin 2013; Statistikat e Mirëqenies Sociale për vitin 2013 (Publikimi përmbledhës vjetor); Statistikat e Mirëqenies Sociale për tremujorin e parë 2014; Statistikat e Mirëqenies Sociale për tremujorin e dytë 2014; Statistikat e Mirëqenies Sociale për tremujorin e tretë 2014; Statistikat e Kulturës për vitin 2013; Statistikat e Sportit 2013; Statistikat e Shëndetësisë për vitin 2013; Statistikat e Arsimit, për çerdhe dhe parashkollorë 2013/2014; Statistikat për Arsimin Fillor dhe të Mesëm të Ulët 2013/2014; Statistikat për Arsimin e Mesëm të Lartë 2013/2014; Statistikat e Arsimit 2013/2014 (Publikimi përmbledhës për të gjitha nivelet e arsimit); dhe Statistikat e Jurisprudencës për Personat e Mitur, për vitin 2013; dhe Statistikat e Jurisprudencës për Personat Madhorë, për vitin 2013.

Sa i përket Statistikave të Popullsisë janë realizuar këto publikime: Migrimi i Popullsisë 2011, Statistikat e Lindjeve 2013, Statistikat e Vdekjeve 2013, Statistikat e Kurorëzimeve 2013, Statistikat e Shkurorëzimeve 2013 dhe Vlerësimi i Popullsisë në Kosovë 2013.

Progresi në Statistikat Sociale është rritur, duke shfrytëzuar standardet ndërkombëtare, sa i përket nomenklaturës dhe metodave të aplikuara, por synim i ASK-së mbetet shkurtimi i kohës së publikimeve.

1.6. Statistikat e Bujqësisë dhe të Mjedisit

Në kuadër të Statistikave të Bujqësisë janë publikuar: Anketa e Ekonomive Shtëpiake Bujqësore 2013. Në Statistikat Agromonetare është publikuar, në baza tremujore, Indeksi i Çmimeve të Prodhimit dhe Çmimet në Bujqësi (TM4 2013 dhe TM1-TM3 2014) dhe Indeksi i Çmimeve të Inputeve Bujqësore (TM4 2013 dhe TM1–TM3 2014) me vitin bazë 2010 = 100. Gjithashtu, në baza vjetore janë publikuar: Indeksi i Çmimeve të Prodhimit dhe Çmimet në Bujqësi 2005–2013 dhe Indeksi i Çmimeve të Inputeve Bujqësore 2005 – 2013, si dhe publikimi Llogaritjet Ekonomike në Bujqësi 2013.

Në fushën e Statistikave të Mjedisit janë publikuar: Anketa e Mbeturinave Komunale 2013 dhe Anketa e Mbeturinave Industriale 2013.

Sa i përket Projektit të Regjistrimit të Bujqësisë (RB), gjatë vitit 2014, është bërë: plotësim-ndryshimi i Ligjit për Regjistrimin e Bujqësisë, rishikimi i planit të aktiviteteve dhe buxhetit për projektin e RB-ë. Janë formuar Komisionet Komunale për Regjistrimin e Bujqësisë në 34 komuna, si dhe janë bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për realizimin e këtij projekti (pyetësorët, udhëzuesit, rekrutimi i personelit, shtypja e materialeve, trajnimet, programi i TI-së, fushata sensibilizuese, etj.). Gjatë periudhës 1-20 nëntor 2014, në kuadër të projektit, janë grumbulluar të dhënat nga terreni. Ndërsa, Anketa Pas Regjistruese (e njohur si PES) e Regjistrimit të Bujqësisë është realizuar në periudhën prej 1-15 dhjetor të viti 2014.

Në statistikat e bujqësisë, agromonetare, të mjedisit dhe gjatë përgatitjes së RB-së janë zbatuar rregulloret, metodat dhe udhëzimet sipas standardeve të organizatave ndërkombëtare, në veçanti ato të Eurostatit.

1.7. Përpunimet e Veçanta të Statistikave Zyrtare

Bazuar në modelet evropiane, në Nenin 33 të Ligjit për Statistika Zyrtare dhe në Udhëzimin Administrativ, Nr.08/12, gjatë vitit 2014 janë arritur dhe realizuar marrëveshje të rëndësishme, lidhur me përpunimin e veçantë të statistikave zyrtare.

Duke zbatuar procedurat e mësipërme ligjore, ASK-ja së bashku me UNICEF-in, kanë finalizuar rezultatet e Anketës së Grupimeve të Treguesve të Shumëfishtë (e njohur si MICS) për vitin 2013. Pastaj, ASK-ja ka realizuar pilot projektet nga fondi i IPA-së 2012, në statistikat ekonomike, sociale dhe statistikat e bujqësisë.

Këto aktivitete të zhvilluara kanë krijuar përvojë të re, duke rritur sasinë dhe cilësinë e prodhimeve statistikore, gjë që kanë mundësuar motivim të stafit të bartësve të statistikave zyrtare, duke ngritur njëkohësisht nivelin profesional të tyre.

1.8. Metodologjia, Shpërndarja dhe Teknologjia Informative

Në aspektin e metodologjisë, gjatë vitit 2014 është bërë nxjerrja e mostrave për të gjitha anketat e kërkuara nga statistikat prodhuese, si dhe të hulumtimeve të tjera të ndryshme, të kërkuara nga projektet e ndryshme, në bashkëpunim me stafin ndërkombëtar. ASK-ja, respektivisht metodologjia, ka nxjerrë mostrat për: Anketën e Fuqisë Punëtore dhe Anketën e Buxhetit të Ekonomive Familjare, ka bërë llogaritjen e peshave për Anketën e Mbeturinave. Po ashtu, është punuar në Anketa Pas Regjistruese (e njohur si PES) për Projektin e Regjistrimit të Bujqësisë. Në bashkëpunim me Statistikat e Suedisë ka filluar Projekti për Dokumentimin e Produkteve Statistikore në sistemin e Metadatave ESMS. Me këtë sistem është punuar në 4 produkte statistikore (AFP, ABEF, IÇK dhe ASN).

Sa i përket sistemeve informative, konsolidimi i TI-së, shërbimet e përbashkëta dhe Qendra e të Dhënave Virtuale, kanë dhënë efekte të konsiderueshme për ASK-në, duke siguruar rritjen e menaxhimit, sigurinë dhe efikasitetin operacional, si dhe ka reduktuar ndjeshëm shpenzimet operative. Në vazhdimësi dhe në bashkëpunim me ekspertët danezë të Projektit të Binjakëzimit, janë zhvilluar aktivitetet për zhvillimin dhe zbatimin e platformës për shpërndarjen e të dhënave statistikore “askdata”, sistem i cili mundëson qasje ‘online’ në bazën e agreguar statistikore.

Për ngritjen e sistemit të sigurisë, ASK-ja ka aplikuar DPM-në, sistem për menaxhimin e mbrojtjes së të dhënave.

Në bashkëpunim me ASHI-në, zyrat rajonale të ASK-së janë kyçur në rrjetin shtetëror të TI-së. Kjo ka ndihmuar në unifikimin e sistemit të brendshëm të ASK-së, lidhjen me institucionet e tjera qeveritare, me qëllim të mbledhjes dhe shkëmbimit të informacionit statistikorë. Gjithashtu, ka

lehtësuar komunikimin me Zyren Qendrore, si dhe ka ulur koston e shpenzimeve të transportit dhe shpenzimet e internetit.

Është bërë dokumentimi i tërë sistemit të TI-së në ASK, që do të ndihmojë për ta lehtësuar bartjen e njohurive institucionale brenda ASK-së.

Sistemi i SIPK-ut është avancuar në vazhdimësi, duke bërë unifikimin e përdoruesve, lehtësuar qasjen dhe ka bërë të mundur monitorimin dhe dokumentimin në mënyrë të vazhdueshme.

Në fushën e TI-së i është dhënë mbështetje departamenteve prodhuese në ofrimin e asistencës teknike, instalimin, konfigurimin dhe trajnime në përdorimin e teknologjive të reja. Është një rritje të vazhdueshme e transmetimit të të dhënave në Eurostat, përmes sistemit unik të transmetimit të të dhënave, i quajtur eDAMIS.

Mbështetje është ofruar edhe në fushën e GIS-it (SIGJ), ku harta e ashtuquajtur ”Njerëzit që udhëtojnë rregullisht për në qytetin e Prishtinës nga vendbanimet e tjera të Kosovës, sipas REKOS-it 2011” ka marrë vlerësimin e parë nga Eurostat-i. Të gjitha publikimeve u është vendosur numri i ISBN-së, u është bërë dizajnimi dhe standardizimi, sipas standardeve për publikimet statistikore.

1.9. Riorganizimi dhe Ngritja e Kapaciteteve në ASK

Në bazë të Ligjit për Statistikat Zyrtare, Rregullores për Riorganizimin dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në ASK, modeleve të ndryshme për riorganizim dhe rekomandimeve të misionit AGA të Eurostat-it, të vitit 2011, edhe gjatë vitit 2014 janë plotësuar pozita me rëndësi në ASK. Është plotësuar pozita e drejtorit në Departamentin e Politikave, Planifikimit, Koordinimit dhe Komunikimit, si dhe janë plotësuar 3 pozita në Departamentin e Anketimeve dhe Regjistrimeve dhe 1 pozitë në Departamentin e Statisikave Sociale.

Përmes këtij riorganizimi është bërë një reformë në ASK, me qëllim të realizimit të misionit, qëllimit dhe objektivave që ka ky institucion.

Me qëllim të rritjes së kapaciteteve profesionale, gjatë vitit 2014, janë mbajtur trajnime të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit. Stafi i ASK-së ka pasur trajnime afatshkurtra dhe afatgjata në fusha të caktuara statistikore. Në termat afatgjate të trajnimit kanë përfituar gjashtë zyrtarë të ASK-së, tre në fushën e statistikave sociale, një në fushën e metodologjisë dhe një në fushën e informimit dhe komunikimit, që janë financuar nga Programi IPA-2012. Në trajnimet afatshkurtra, stafi i ASK-së dhe institucionet e tjera kanë marrë pjesë në trajnime nga fushat statistikore, seminare, konferenca dhe vizita studimore. Në total, numri i trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve është 320 (shih Shtojcën 2).

Mbështetja, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve profesionale dhe efikasitetit në punë, është financuar kryesisht nga organizatat ndërkombëtare.

Sipas Rregullores Nr. 09/2012 për Standardet e Riorganizimit të Brendshëm dhe Sistematizimit

të Vendeve të Punës në Administratën Shtetërore dhe Rregullores Nr. 05/2012 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, ASK-ja ka finalizuar procesin e sistematizimit dhe klasifikimit të vendeve të punës, dhe e ka dërguar në MAP për procedim të mëtutjeshëm.

Sipas PSZ-së 2013-2017, ngritja e kapaciteteve njerëzore në aspektin e numrit të stafit dhe atë profesional është prioritet i vazhdueshëm. ASK-ja, në mënyrë të vazhduar, ka dërguar kërkesat

te institucionet vendimmarrëse për 29 pozita të reja. Në rast të aprovimit të këtyre kërkesave shpërndarja e pozitave do të bëhet sipas prioriteteve, në kuadër të departamenteve prodhuese, në veçanti në krijimin e Departamentit të Llogarive Kombëtare.

Pozitat e lira, që janë krijuar me rastin e daljes në pension të pozitave të caktuara janë plotësuar gjatë vitit 2014.

Numri i pamjaftueshëm i stafit ka ndikuar dhe do të ndikojë në prodhimin e statistikave, sipas standardeve dhe metodologjisë ndërkombëtare.

1.10. Pasqyrat e Performancës së ASK-së

Gjatë vitit 2014, numri i produkteve, respektivisht publikimeve statistikore, ka shënuar rritje të konsiderueshme krahasuar me një vit më parë. Objektivi i caktuar në Programin e Statistikave Zyrtare 2013-2017, lidhur me numrin e produkteve statistikore, tanimë është arritur. Në fund të vitit 2014, ASK-ja kishte arritur t'i prodhojë 47 produkte statistikore dhe 103 publikime, krahasuar me vitin 2013. Numri i produkteve statistikore të publikuara ishte 41, respektivisht 93 publikime statistikore. Shprehur në tregues strukturorë, performanca nga pikëpamja e prodhimit statistikor, gjatë vitit 2014, ishte mjaft e lartë, në produktet statistikore me mbi 14%, respektivisht mbi 10% publikime statistikore.

Është përmirësuar performanca e kohës së prodhimeve statistikore dhe e publikimit të tyre, sipas kohës së planifikuar. Ky progres ndihmon prioritetet në përgjithësi, që ka ASK-ja, sidomos te BPV-ja, si dhe në zhvillimin e kapaciteteve menaxheriale dhe organizative të ASK-së.

Efikasiteti i prodhimeve ka shënuar progres të rëndësishëm në statistikat ekonomike, në zvogëlimin kohës së prodhimit për 12% dhe numrit të publikimeve në kohë nga 74% në 90%. Ndërsa, te statistikat e bujqësisë ka pasur zvogëlim të kohës së prodhimit për 1% dhe numrit të publikimeve në kohë nga 71% në 92%. Tejkalim të afatit kohor, ka pasur në statistikat sociale, për shkak të varësisë së ASK-së nga ekspertiza ndërkombëtare për AFP-në, mosdërgimi në kohë i të dhënave administrative nga disa institucione, dhe procesi i finalizimit të riorganizimit të ASK-së.

Korniza e Vlerësimit të Performancës (KVP) ende nuk është aplikuar në tërësi, për të dhënë raporte sistematike për zhvillimin e kualitetit të statistikave. Pasqyrë më të qartë, lidhur me zhvillimin e kualitetit, pritet të ketë nga mesi i vitit 2015.

Në tabelat e mëposhtme janë dhënë pasqyrat e performancës në nivel të ASK-së dhe në nivel të departamenteve, sipas treguesve të nxjerrë nga Sistemi i Përdorimit të Kohës (SIPK), sistem i cili ka qenë në fazën testuese të aplikimit.

Tabela: 1.1. Pasqyra e performancës në nivel të ASK-ës (SIPK)

Treguesi 1. Numri i produkteve

Depertamenti	Produktet 2013	Produktet 2014	Publikimet 2013	Publikimet 2014
DSELLK	14	20	54	62
DSBM	9	9	14	14
DSS	14	14	16	19
DMTI	4	4	9	9
Gjithsej	41	47	93	104

Treguesi 4. Ditë pune - njeri për produkt

Depertamenti	Dite pune (planif.)	Dite pune (realiz.)	Ndryshimi (%)
DSELLK	4.989	2.699	(46)
DSBM	3.180	1.651	(48)
DSS	3.217	2.795	(13)
DMTI	112	88	(21)
Gjithsej	11.498	7.233	(37)

Depertamenti	Gjithsej ditë pune	Në procesin prodhues	Jashtë procesit prodhues	Proporcioni i jashtëm (%)
DSELLK	3.118	2.699	419	13,4
DSBM	1.889	1.651	238	12,6
DSS	3.080	2.795	285	9,3
DMTI	335	88	247	73,7
Gjithsej	8.422	7.233	1.189	14,1

Treguesi 5. Koha prodhuese

Depertamenti	Koha prodhuese 2013	Koha prodhuese 2014	Ndryshimi (%)
DSELLK	3.346	2.934	(12)
DSBM	1.102	1.089	(1)
DSS	1.483	2.476	67
DMTI	280	273	(3)
Gjithsej	6.211	6.772	9

Treguesi 6. Shkalla e publikimeve në kohë

Depertamenti	Produktet 2014	Publikimet 2014	Në kohë	Proporcioni në kohë 2014 (%)	Proporcioni në kohë 2013 (%)
DSELLK	20	62	56	90	74
DSBM	9	14	12	86	71
DSS	14	19	6	32	6
DMTI	4	9	8	89	56
Gjithsej	47	104	82	80	60

Perfomanca përmbledhëse në nivel të ASK-së

ASK	Viti 2013	Viti 2014	Ndryshimi (%)
Treguesi 1a: Nr.i produkteve	41	47	15
Treguesi 1b: Nr. i publikimeve	93	104	12
Treguesi 4: Ditë pune/produkt	204	157	(23)
Treguesi 4a: Ditë pune/produkt për vitet që krahasohen	147	166	13
Treguesi 5: Koha prodhuese	8,417	9,868	17
Treguesi 6: Shkalla e publikimeve në kohë	56	82	46

Tabela: 1.2. Pasqyra e performancës sipas departamenteve të ASK-ës (SIPK)

Fusha e Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare

Treguesi 4. Ditë pune/produkt

DSELLK (Treguesi 4)	Ditë Pune (Plan)	Ditë Pune (Real.)	Ndryshimi (%)
Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve ASN	230	232	1
Indeksi i Çmimeve të Importit IÇIMP	240	158	(34)
Indeksi i Çmimeve të Prodhimit IÇP	230	223	(3)
Statistikat Afatshkurta të Industrisë	382	181	(53)
Repertori Statistikor i Ndërmarrjeve në Kosovë	88	7	(92)
Indeksi i Çmimeve të Konsumit IÇK-IHÇK	336	276	(18)
Të dhënat e Tregtisë së Jashtme	298	102	(66)
Bruto Produkti Vendor (BPV) sipas qasjes së shpenzimeve	359	164	(54)
Bruto Produkti Vendor (BPV) sipas qasjes së prodhimit	321	192	(40)
Llogaritë Qeveritare	109	27	(75)
Indeksi i Kostos sw Ndërtimit IKN	325	163	(50)
Bilanci i Energjisë	92	24	(74)
Të dhënat mbi Transportin	83	152	83
Të dhënat mbi Hotelerinë	191	203	6
Statistikat Afatshkurtra të Ndërtimtarisë	380	73	(81)
Statistikat Afatshkurtra të Tregtisë me Pakicë	261	60	(77)
Freskimi i Regjistrit Statistikor të Bizneseve	102	89	(13)
Indeksi i Çmimeve të Konsumit IÇK (Vjetor)	45	11	(77)
Të dhënat e Tregtisë së Jashtme (Vjetor)	46	0	(99)
Bruto Produkti Vendor (BPV) sipas qasjes së shpenzimeve dhe prodhimit (Tremujore)	871	364	(58)
Ditë pune në total sipas produktit/departamentit	4,989	2,699	(46)
Ditë pune brenda proceseve prodhuese		2,699	87
Ditë pune jashtë proceseve prodhuese		419	13
prej të cilave punë me palë		377	90
prej të cilave në trajnim		343	82
Gjithsej ditë pune të regjistruara		3,118	

Treguesit 1, 5 dhe 6. Tabela përmbledhëse

DSELLK (Treguesit 1, 5 dhe 6)	Produkte	Publikime	Në kohë	Prodhimi 2013	Prodhimi 2014	Ndrysh.në prodhim
Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve ASN	1	-	0	353		
Indeksi i Çmimeve të Importit IÇIMP	1	4	4	315	324	9
Indeksi i Çmimeve të Prodhimit IÇP	1	4	3	325	358	33
Statistikat Afatshkurta të Industrisë	1	4	1		682	
Repertori Statistikor i Ndërmarrjeve në Kosovë	1	4	3	161	165	4
Indeksi i Çmimeve të Konsumit IÇK-IHÇK	1	13	12	158	167	9
Të dhënat e Tregtisë së Jashtme	1	14	14	493	410	(83)
Bruto Produkti Vendor (BPV) sipas qasjes së shpenzimeve	1	1	1	262	255	(7)
Bruto Produkti Vendor (BPV) sipas qasjes së prodhimit	1	1	1	360	329	(31)
Llogaritë Qeveritare	1	1	1	183	168	(15)
Indeksi i Kostos së Ndërtimit IKN	1	3	3		259	
Bilanci i Energjisë	1	4	4	336	316	(20)
Të dhënat mbi Transportin	1	4	4	145	140	(5)
Të dhënat mbi Hotelerinë	1	4	4	292	302	10
Statistikat Afatshkurtra të Ndërtimtarisë	1	-	0			
Statistikat Afatshkurtra të Tregtisë me Pakicë	1	-	0			
Freskimi i Regjistrit Statistikor të Bizneseve	1	-	0			
Indeksi i Çmimeve të Konsumit IÇK (Vjetor)	1	-	0			
Të dhënat e Tregtisë së Jashtme (Vjetor)	1	-	0			
Bruto Produkti Vendor (BPV) sipas qasjes së shpenzimeve dhe prodhimit (Tremujore)	1	1	1		249	
Produkte/publikime	20	62	56			
Shkalla e publikimeve në kohë		-	90%			
Koha prodhuese		-	0	3346	2934	(412)
Ndryshimi në kohën prodhuese		-	0			-12%

Performanca në nivel departamenti

DSELLK	Viti 2013	Viti 2014	Ndryshimi (%)
Treguesi 1a: Nr. i produkteve	14	20	43
Treguesi 1b: Nr. i publikimeve	54	62	15
Treguesi 4: Ditë pune/produkt	150	135	(10)
Treguesi 4a: Ditë pune/produkt për vitet që krahasohen	150	150	-
Treguesi 5: Koha prodhuese	3,383	4,124	22
Treguesi 6: Shkalla e publikimeve në kohë	40	56	40

Fusha e Statistikave Sociale

Treguesi 4. Ditë pune/produkt

DSS (Treguesi 4)	Ditë Pune (Plan)	Ditë Pune (Real.)	Ndryshimi (%)
Anketa e Fuqisë Punëtore (AFP)	552	447	(19)
Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare (ABEF)	812	819	1
Statistikat e Mirëqenies Sociale	220	155	(30)
Statistikat e Arsimit	386	326	(15)
Statistikat e Jurisprudencës	341	321	(6)
Statistikat e Shëndetësisë	217	145	(33)
Statistikat e Kulturës dhe Sportit	245	197	(20)
Statistikat e Lindjeve	89	126	41
Statistikat e Vdekjeve	75	114	51
Statistikat e Martesave	58	56	(4)
Statistikat e Shkurorëzimeve	76	24	(69)
Statistikat mbi shkaqet e vdekjeve	76	64	(16)
Burrat dhe Gratë në Kosovë	70	3	(96)
Ditë pune në total, sipas produktit/departamentit	3.217	2.795	(13)
Ditë pune brenda proceseve prodhuese		2.795	91
Ditë pune jashtë proceseve prodhuese		285	9
prej të cilave punë me palë		20	7
prej të cilave në trajnim		150	53
Gjithsej ditë pune të regjistruara		3.080	

Treguesit 1, 5 dhe 6. Tabela përmbledhëse

DSS (Treguesit 1, 5 dhe 6)	Produkte	Publikime	Në kohë	Prodhimi 2013	Prodhimi 2014	Ndrysh.në prodhim
Anketa e Fuqisë Punëtore (AFP)	1	1	-	140	342	202
Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare (AI	1	1	1	161	162	1
Statistikat e Mirëqenies Sociale	1	4	2	424	212	(212)
Statistikat e Arsimit	1	4	-	169	549	380
Statistikat e Jurisprudencës	1	2	1	449	567	118
Statistikat e Shëndetësisë	1	1	1	352	309	(43)
Statistikat e Kulturës dhe Sportit	1	2	1	343	655	312
Statistikat e Lindjeve	1	1	-	171	303	132
Statistikat e Vdekjeve	1	1	-	190	251	61
Statistikat e kurorëzimeve	1	1	-	209	350	141
Statistikat e Shkurorëzimeve	1	1	-	209	322	113
Statistikat mbi shkaqet e vdekjeve	1	-	-	-	-	-
Burrat dhe Gratë në Kosovë	1	-	-	464	-	-
produkte/publikime	13	19	6	-	-	-
Shkalla e publikimeve në kohë		-	32%	-	-	-
Koha prodhuese		-	0	1,483	2,476	993
Ndryshimi në kohën prodhuese		-	0			67%

Performanca në nivel departamenti

DSS	Viti 2013	Viti 2014	Ndryshimi (%)
Treguesi 1a: Nr. i produkteve	13	14	7.7
Treguesi 1b: Nr. i publikimeve	16	19	18.8
Treguesi 4: Ditë pune/produkt	177	215	21.5
Treguesi 4a: Ditë pune/produkt për vitet që krahasohen	177	215	21.5
Treguesi 5: Koha prodhuese	3,281	4,022	22.6
Treguesi 6: Shkalla e publikimeve në kohë	1	6	500

Fusha e Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit

Treguesi 4. Ditë pune/produkt

DSBM (Treguesi 4)	Ditë Pune (Plan)	Ditë Pune (Real.)	Ndryshimi (%)
Regjistrimi i Bujqësisë	1.664	696	(58)
Statistikat Agromonetare/indekset e çmimeve të outputeve bujqësore	244	189	(23)
Statistikat Agromonetare/të dhënat ekonomike për bujqësinë EAA	217	46	(79)
Anketa e Mbeturinave Industriale	165	180	9
Anketa e Mbeturinave Komunale	159	128	(19)
Burimet administrative (Disa Fakte mbi Mjedisin)	123	167	36
Burimet administrative (Statistikat e Ajrit-studim provues)	121	119	(2)
Anketa e Ekonomive Shtëpiake Bujqësore	243	95	(61)
Statistikat Agromonetare/indekset e çmimeve të inputeve bujqësore	244	31	(87)
Ditë pune në total sipas produktit/departamentit	3.180	1.651	(48)
Ditë pune brenda proceseve prodhuese		1.651	87
Ditë pune jashtë proceseve prodhuese		238	13
prej të cilave punë me palë		-	0
prej të cilave në trajnim		126	53
Gjithsej ditë pune të regjistruara		1.889	

Treguesit 1, 5 dhe 6. Tabela përmbledhëse

DSBM (Treguesit 1, 5 dhe 6)	Produkte	Publikime	Në kohë	Prodhimi 2013	Prodhimi 2014	Ndrysh. në prodhim
Regjistrimi i Bujqësisë	1	-	-			
Statistikat Agromonetare/indekset e çmimeve të outputeve bujqësore	1	5	5	184	180	(4)
Statistikat Agromonetare/të dhënat ekonomike për bujqësinë EAA	1	-	-			-
Anketa e Mbeturinave Industriale	1	1	1	357	351	(6)
Anketa e Mbeturinave Komunale	1	1	1	364	360	(4)
Burimet administrative (Disa Fakte mbi Mjedisin)	1	-	-	161	0	
Burimet administrative (Statistikat e Ajrit - studim provues)	1	-	-			-
Anketa e Ekonomive Shtëpiake Bujqësore	1	1	-	210	360	150
Statistikat Agromonetare/indekset e çmimeve të inputeve bujqësore	1	5	5	197	198	1
Produkte/publikime	9	13	12			
Shkalla e publikimeve në kohë		-	92%			
Koha prodhuese		-	0	1102	1089	(13)
Ndryshimi në kohën prodhuese		-	0			-1%

